

L I G J
Nr.8783, datë 7.5.2001

**PËR MIRATIMIN E “MARRËVESHJES SË KONCENSIONIT TË FORMËS “BOT”
NDËRMJET MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE, MINISTRISË SË EKONOMISË
PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT, BASHKISË SË QYTETIT TË ELBASANIT DHE
BERLINWASSER INTERNATIONAL, GMBH PËR NDËRMARRJEN E UJËSJELLËSIT
DHE UJË-KANALIZIMEVE ELBASAN”, SI DHE DHËNIEN E DISA STIMUJVE DHE
GARANCIVE PËR KONCENSIONARIN E KËSAJ MARRËVESHJEJE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :**

Neni 1

Miratohet “Marrëveshja e koncensionit të formës “BOT” ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe BerlinWasser International, GmbH për Ndërmarrjen e Ujësjiellësit dhe Ujë-Kanalizimeve Elbasan”, sipas Marrëveshjes që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Në Marrëveshjen e Koncensionit të formës “BOT”, për Ndërmarrjen e Ujësjiellësit dhe Ujë-Kanalizimeve Elbasan ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Bashkisë së qytetit të Elbasanit dhe BerlinWasser International, GmbH, shoqëria koncensionare e themeluar prej kësaj të fundit, do të përjashtohet nga:

- detyrimet për pagimin e taksës doganore dhe të TVSH-së për të gjitha makineritë, pajisjet dhe materialet e importuara për qëllime investimi, për një periudhë 10-vjeçare, që nga data e fillimit, ashtu siç përcaktohet në Marrëveshjen e Koncensionit.

Neni 3

Palët kontraktuese janë të detyruara të zbatojnë kriteret e caktuara në pikën 4 të nenit 11 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”.

Neni 4

Objekte të Marrëveshjes së Koncensionit, nuk do të jenë subjekt i privatizimit, sipas ligjit nr.8103, datë 28.3.1996 “Për privatizimin e ndërmarrjeve të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të përdorura”, ose të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”. Shoqëria do të ketë titull të plotë pronësie për kapitalet e reja, të përcaktuara në Marrëveshjen e Koncensionit, me përjashtim të atyre që parashikohen në nenet 174 dhe 176 të Kodit Civil.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, si organe shtetërore të autorizuar, të asistojnë shoqërinë koncensionare në sigurimin prej saj të të drejtave, të autorizimeve dhe të lejeve të parashikuara në kreun IV dhe V të ligjit nr.8093, datë

21.3.1996 “Për rezervat ujore” .

Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe i largimit të ujërave të përdorura, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit, Këshilli Kombëtar i Ujit dhe Inspektorati Sanitar i Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi në sektorët përkatës, ngarkohen të zbatojnë termat dhe kushtet e Marrëveshjes së Konkensionit.

Neni 6

Këshilli i Ministrave, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Konkensionit, trajton detyrimet ndaj Buxhetit të Shtetit dhe të tretëve, që janë objekt i konkensionit.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3011, datë 18.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**